



Njësia Policore e Specializuar e Misionit të Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë

Njësia Policore e Specializuar (NJPS) e Misionit të Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë (EULEX) përbëhet nga **105 zyrtarë policorë të dërguar nga Polonia.**

Objektivi kryesor i NJPS-së është që ta mbështesë stabilitetin e Kosovës dhe të kontribuojë për sigurinë e grave, burrave, vajzave dhe djemve nga të gjitha **komunitetet** në Kosovë.

REAGUESI I DYTË I SIGURISË

NJPS e EULEX-it është **reaguesi i dytë i Kosovës për sigurinë**, si pjesë përbërëse e mekanizmit treshresorë të reaguesve në fushën e sigurisë, ku Policia e Kosovës është reaguesi i parë i sigurisë, EULEX-i është i dyti, ndërsa NATO/KFOR-i është i treti.



Në rolin e saj si reagues i dytë i sigurisë, NJPS e EULEX-it mund të angazhohet **vetëm me kërkesë të drejtpërdrejtë** të reaguesit të parë të sigurisë me qëllim të kontribimit për ruajtjen dhe avancimin e rendit publik dhe sigurisë në raste të trazirave qytetare.



Prej qershor 2018 deri më sot, NJPS ka vepruar si reagues i dytë i sigurisë në **dy raste**:

- Më **28 maj 2019**, NJPS shtoi shpeshtësinë e patrullimeve në pjesën veriore të Kosovës për më gjatë se një javë me kërkesë të Policisë së Kosovës, pas një operacioni kundër kontrabandës që u realizua atë ditë.
- Prej datës **20 shtator deri 14 tetor 2021**, NJPS e EULEX-it u dislokua në pikëkalimet e përbashkëta Bërnjak/Tabalije dhe Rudnicë/Jarinjë me një rol vëzhgimi, me kërkesë të Policisë së Kosovës dhe në përputhje me mandatin e EULEX-it si reagues i dytë i Kosovës për sigurinë.

Një **Forcë e Reagimit të Shpejtë (FRSH)** qëndron në gjendje gatishmërie 24 orë në ditë në Mitrovicë dhe mund të reagojë brenda një kohe shumë të shkurtër.



PATRULLIMET VËZHGUESE

Për të qenë të informuar rreth situatës, NJPS kryen patrullime vëzhgimi mobile 24/7, me ndërime.



STËRVITJET PËR KONTROLLIN E TURMAVE DHE TRAZIRAVE



NJPS është duke i mbështetur strukturat e Policisë së Kosovës për kontrollin e turmave dhe trazirave përmes organizimit të stërvitjeve trajnuese në nivele të stafit taktik dhe komandues. Përmes këtyre stërvitjeve, Policia e Kosovës, EULEX-i dhe NATO/KFOR-i, tre reaguesit e Kosovës për sigurinë, sigurojnë **koordinim të lehtë** në rast të një dislokimi të vërtetë.



Prej datës 15 qershor 2018 deri 14 qershor 2023, NJPS ka marrë pjesë në dhjetë trajnime të përbashkëta me Policinë e Kosovës dhe KFOR-in, 11 trajnime me Policinë e Kosovës dhe 70 trajnime me NATO/KFOR-in.

AKTIVITETET TJERA



NJPS u ofron mbështetje operacionale Dhomave të Specializuara dhe Zyrës së Prokurorit të Specializuar të Kosovës në përputhje me legjislacionin përkatës të Kosovës.



NJPS vijon me stërvitje të rregullta për t'i ruajtur dhe zhvilluar më tej aftësitë e saj përmes trajnimeve për qitje, trajnimeve në aftësitë orientuese, trajnimeve për përdorimin e armëve të zjarrit, trajnimeve për përdorimin e pajisjeve me rreze x, trajnimeve taktike luftarake për shpëtimin e jetës, trajnimeve për evakuim mjekësor dhe trajnimeve për përdorimin e forcës. Pjesëtarët e NJPS-së dhurojnë gjak rregullisht.



Në dhjetor 2022, gjatë krizës së sigurisë në pjesën veriore të Kosovës, NJPS ka bërë dërgime të furnizimeve esenciale për zyrtarët e Policisë së Kosovës në pikë-kalimin e përbashkët Rudnicë/Jarinjë dhe ka shoqëruar zyrtarë policorë të rregullt të Policisë së Kosovës gjatë ndërrimeve dhe zëvendësimeve të zyrtarëve policorë të rregullt në stacionin policor në Leposaviq.

Duke e marrë parasysh mjedisin e sigurisë në Kosovë, NJPS mund të përforcohet përkohësisht me një **NJPS Rezervë** si përgjigje ndaj nevojës së EULEX-it për forca shtesë në terren dhe që EULEX-i të mund t'i mbështetë më mirë homologët e tij kosovarë, sipas kërkesës dhe nevojës. Që nga marsi 2022, xhandarë nga Portugalia, Franca, Italia dhe Lituania të siguruar nga Forca Evropiane e Xhandarmerisë janë dislokuar përkohësisht në Kosovë. Gjatë kohës së dislokimit të NJPS-ve Rezervënë Kosovë, **NJPS dhe NJPS Rezervë punojnë krah për krah për përmbushjen e mandatit të EULEX-it**. Gjithashtu, ato marrin pjesë në trajnime të përbashkëta me Policinë e Kosovës dhe KFOR-in.

